

Së shpejti

FORUMI MË I MADH I HOTELERISË



**FUTURE
HOSPITALITY
FORUM**

Future Hospitality Forum bën bashkë:

-  Institucionet arsimore & ofruesit e trajnimeve
-  Agjencitë e punësimit & programet e OKB-së
-  Platformat globale si Booking.com
-  Liderët e teknologjisë, arkitekturës e dizajnit

broshura

MË SKANO



02

TETOR
2026



TKOB, TIRANË

09:00 – 16:00

Së shpejti, forumi më i madh i hotelerisë – Future Hospitality Forum | 2 Tetor 2026 , TKOB, Tiranë

Shqipëria po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e mediave dhe publikimeve ndërkombëtare si një nga destinacionet turistike me potencialin më të madh në rajon. Ky interes po krijon mundësi të reja për investime, partneritete dhe zhvillim të qëndrueshëm në sektorin e mikpritjes.

Pikërisht në këtë moment të rëndësishëm, Future Hospitality Forum 2026 krijon platformën ku zhvilluesit e projekteve turistike, investitorët dhe markat më të njohura ndërkombëtare të hotelerisë takohen për të ndërtuar partneritetet që do të formësojnë të ardhmen e mikpritjes në Shqipëri.

Liderë të industrisë dhe figura të shquara do të mbledhen së bashku në panele ekspertësh, për të trajtuar trendet më të fundit që po transformojnë sektorin e turizmit dhe mikpritjes.

- Pjesëmarrësit do të njihen me strategji dhe rrugë të reja investimi për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Në të njëjtën kohë, do të kenë mundësinë të krijojnë lidhje të drejtpërdrejta me investitorë dhe partnerë të mundshëm për sipërmarrje të reja biznesi.

FHF (Future Hospitality Forum) bashkon udhëheqjen institucionale, përvojën globale dhe fuqinë e rrjeteve të biznesit për të formësuar të ardhmen e turizmit dhe mikpritjes në Shqipëri. Ajo është një platformë strategjike ku vizioni publik takohet me ekspertizën ndërkombëtare, duke krijuar mundësi për investime, partneritete të reja dhe bashkëpunime të drejtpërdrejta B2B me aktorët kryesorë të industrisë.

- Udhëheqje Institucionale
- Përvojë Globale
- Ekosistem & B2B i Drejtpërdrejtë

Future Hospitality Forum bën bashkë:

- 🎓 Institucionet arsimore & ofruesit e trajnimeve
- 💼 Agjencitë e punësimit & programet e OKB-së
- 🌐 Platformat globale si Booking.com
- 💡 Liderët e teknologjisë, arkitekturës e dizajnit

Së bashku, po formësojmë kapitalin njerëzor, zgjidhjet digjitale dhe strukturat e së ardhmes për sektorin e turizmit!

Shfletoni broshurën për t'u njohur me konceptin e plotë të FHF:

<https://aida.gov.al/wp-content/uploads/2026/07/Future-hospitality-FORUM-Concept-Note-1.pdf>

📅 2 Tetor 2026 | 📍 TKOB, Tiranë

BUILDING VALUES. CONNECTING BRANDS.

BRIDGE2EU | Nga Potenciali Lokal drejt Mundësive Evropiane

Ke një biznes dhe synon të zgjerohesh në tregun evropian? Po kërkon mundësi financimi dhe nuk di ku ta nisësh?

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Brain Nest Institute, lançon BRIDGE2EU – Nga Potenciali Lokal drejt Mundësive Evropiane, një iniciativë e dedikuar për të mbështetur NVM-të shqiptare në orientimin dhe aksesin drejt mundësive evropiane të financimit dhe zhvillimit.

BRIDGE2EU nis nga nevojat konkrete të biznesit: çfarë dëshiron të zhvillosh, çfarë investimi të nevojitet dhe cilat mundësi evropiane mund të të ndihmojnë të arrish objektivat e tua.

Përmes 4 workshopeve të dedikuara, pjesëmarrësit do të njihen me:

- Programet dhe instrumentet e financimit të BE-së
- Programin për Tregun e Përbashkët (Single Market Programme)
- Mundësitë e financimit në kaskadë (cascade funding)
- Instrumentet financiare për bizneset
- Mundësitë në inovacion, digjitalizim dhe tranzicionin e gjelbër
- Mënyrën e kërkimit dhe aplikimit për thirrjet e BE-së
- Identifikimin e partnerëve të përshtatshëm
- Përgatitjen e një Concept Note për një projekt konkret

Hapi i parë nis me njohjen e nevojave të biznesit tuaj.

Ftojme të gjitha NVM-të e interesuara të plotësojnë Formularin e Regjistrimit dhe Identifikimit të Nevojave.



AIDA pret delegacionin e investorëve arabë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) priti një delegacion investorësh dhe përfaqësuesish të grupeve të biznesit arab, me interes për mundësitë e investimit në Shqipëri.

Gjatë takimit, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Znj. Laura Saro, dhe Zv/ministri i Ekonomisë dhe Inovacionit, Z. Enkelejd Musabelliu, prezantuan një panoramë të klimës së investimeve në Shqipëri, potencialit të ekonomisë shqiptare dhe mundësive që ofrojnë sektorë të ndryshëm, ndërsa u ndalën edhe te procesi i integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe perspektivat e reja që ai krijon për investorët.

Delegacioni përbëhej nga kompani në sektorë si energjia, ndërtimi, zhvillimi imobiliar, turizmi, bujqësia, dhe shërbimet.

Takimi shërbeu si një mundësi për prezantimin e potencialit investues të Shqipërisë dhe për identifikimin e fushave të interesit për bashkëpunim dhe investime të reja.



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: FUTURE PROOF TEXTILES

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: FUTURE PROOF TEXTILES (Mbështetja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorin tekstil drejt tranzicionit digjital dhe atij të gjelbër – 1st Open Call)

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/futureprooftextiles-mbeshtetja-e-ndermarrjeve-te-vogla-dhe-te-mesme-ne-sektorin-tekstil-drejt-tranzicionit-digjital-dhe-atij-te-gjelber-1st-open-call>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: AI-BOOST – AI Challenge Competition

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: AI-BOOST – AI Challenge Competition

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/ai-boost-ai-challenge-competition>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: Programi IDEA Agro

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare dhe programeve trajnuese, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: Programi IDEA Agro

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimi dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/programi-idea-agro>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: Ready4EIC: Program Trajnimi për SME-të Inovative në Shtetet e Zgjerimit të BE-së

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare dhe programeve trajnuese, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: Ready4EIC: Program Trajnimi për SME-të Inovative në Shtetet e Zgjerimit të BE-së

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimi dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/ready4eic-training-programme-for-innovative-smes-in-eu-enlargement-countries>




AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: POWERUP NETZERO – Innovation Projects Open Call

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare dhe programeve trajnuese, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: POWERUP NETZERO – Innovation Projects Open Call

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimi dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/powerup-netzero-innovation-projects-open-call>



AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: 7th Open Call for Small-Scale Project Proposals under Specific Objective (S.O.) 4.6 of the IPA CBC Greece–Albania Programme

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare dhe programeve trajnuese, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin "Akses në Financë" mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: 7th Open Call for Small-Scale Project Proposals under Specific Objective (S.O.) 4.6 of the IPA CBC Greece–Albania Programme

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimi dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun:

<https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/7th-open-call-for-small-scale-project-proposals-under-s-o-4-6-ipa-cbc-greece-albania-programme>



Investimet e Huaja Direkte vijojnë të rriten në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare | T1 2026

Sipas të dhënave më të fundit të Bankës së Shqipërisë, të përpunuara nga AIDA, tremujori i parë i vitit 2026 shënon rritje të ndjeshme të fluksit të Investimeve të Huaja Direkte krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025.

Tre sektorët me performancën më të lartë janë:

- Aktivitetet e pasurive të paluajtshme | +65.4%
- Informacioni dhe komunikacioni | +64.3%
- Energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë | +40.7%

Këto rezultate konfirmojnë besimin në rritje të investitorëve dhe potencialin e Shqipërisë në sektorë me vlerë të shtuar, duke reflektuar një ekonomi gjithnjë e më konkurruese dhe tërheqëse për investime.

Burimi: Banka e Shqipërisë, të dhëna të përpunuara nga AIDA.



Investimet e Huaja Direkte vijojnë të rriten në sektorët strategjikë të ekonomisë shqiptare | T1 2026

Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit, deri më korrik 2026, në Shqipëri operojnë 19,370 kompani me kapital të huaj ose të përbashkët, ku 16,093 janë me kapital 100% të huaj dhe 3,277 me kapital të përbashkët.

Italia mbetet partneri kryesor për nga numri i kompanive, ndërsa Tirana përqendron mbi 66% të tyre. Aktiviteti ekonomik dominohet nga sektori i shërbimeve (41.1%).

Shqipëria vazhdon të konsolidohet si një destinacion tërheqës për investimet e huaja.

Burimi: QKB, të dhëna të përpunuara nga AIDA

Treguesit e tregut të punës shënojnë përmirësim | T1 2026.

Sipas të dhënave më të fundit të INSTAT, norma e papunësisë në Shqipëri gjatë periudhës janar-mars 2026 zbriti në 8.4%, nga 8.7% në të njëjtën periudhë të vitit 2025.

T1 2025: 8.7%

T1 2026: 8.4%


Rënie: 0.3 pikë përqindje

Ulja e normës së papunësisë pasqyron zhvillimet pozitive në tregun e punës dhe krijon një mjedis më të favorshëm për rritjen ekonomike, zhvillimin e biznesit dhe tërheqjen e investimeve.

Burimi: INSTAT. Përpunuar nga AIDA.




SHPËRNDARJA E KOMPANIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK



SHPËRNDARJA E KOMPANIVE SIPAS QARQEVË



SHPËRNDARJA E KOMPANIVE SIPAS ORIGJINËS SË KAPITALIT



Kompani Aktive
19,370

Kapital 100% i huaj

16,093

Aktive

Kapital i përbashkët

3,277

Aktive

Platforma EXPORT ALBANIA | Moduli Kompas

Zbuloni mundësitë e reja për biznesin tuaj me Export Albania dhe modulit Kompas si Instrument Strategjik për Rritjen e Eksportit

AIDA ofron akses falas në platformën globale B2B Kompas EasyBusiness për të gjitha bizneset shqiptare të regjistruara në ExportAlbania.al, me qëllim fuqizimin e eksporteve dhe ndërtimin e partneriteteve ndërkombëtare.

Përfitimet Kryesore për Bizneset Shqiptare:

- Gjenerim i Klientëve Potencialë : Akses i drejtpërdrejtë në kontakte të verifikuara biznesi në mbarë botën.
- Analizë e Detajuar e Tregjeve: Informacion mbi kërkesën, trendet dhe konkurrencën në tregjet globale.
- Gjetje Partnerësh Strategjikë: Mundësi lidhjeje me blerës, shpërndarës dhe bashkëpunëtorë ndërkombëtarë.
- Akses pa Pagesë: Shërbim i financuar nga AIDA për sipërmarrjet e regjistruara në portalin zyrtar të eksportit.

Për të marrë akses falas në platformë, bizneset duhet të jenë të regjistruara pranë ExportAlbania.al.

✉ Email: info@exportalbania.gov.al

☎ Telefon: +355 4 225 1001

Përfitimet e biznesit tuaj nga fushata "AIDA x AIC x Bashkitë"

AIDA, AIC dhe Bashkitë sjellin një seri takimesh informuese për të mbështetur zhvillimin e biznesit dhe investimeve në nivel lokal.

Gjatë këtyre takimeve, bizneset do të njihen me programet e mbështetjes së AIDA-s, mundësitë e financimit, promovimin e eksporteve dhe shërbimet që ndihmojnë rritjen e konkurrueshmërisë. Njëkohësisht, do të prezantohen edhe mundësitë që ofron AIC për zhvillimin e investimeve përmes transformimit të aseteve publike, rigjallërimit të hapësirave urbane dhe nxitjes së partneriteteve me sektorin privat.

Pjesëmarrja në takimet e fushatës nuk është thjesht informim — është një investim direkt në zhvillimin e biznesit tuaj. Ja çfarë përfitoni:

Përfitimet nga AIDA:

- 1.Zbuloni instrumente konkrete që mund t'i aplikoni menjëherë në biznesin tuaj.
- 2.Identifikoni burimin e financimit që i përshtatet nevojave tuaja.
- 3.Regjistrohuni dhe përfitoni drejtpërdrejt nga Export Albania, Kompas, EEN Albania dhe Akses në Financë.
- 4.Hapni rrugë të reja drejt eksportit dhe tregjeve ndërkombëtare.
- 5.Ndërtoni kontakte me ekspertë e biznese të tjera.
- 6.Bëheni pjesë në rrjetin e AIDA-s, për akses dhe mundësi të reja.

Përfitimet nga AIC:

- 1.Përfitoni akses më të thjeshtë në shërbimet publike.
- 2.Gjeni asete publike të reja për zhvillimin e biznesit.
- 3.Operoni në një mjedis urban më funksional që tërheq më shumë klientë.
- 4.Përfitoni nga administrimi i qëndrueshëm i pronave.
- 5.Kapni mundësi biznesi nga asete të rikualifikuara.

Bëhuni pjesë e takimeve dhe ktheni informacionin në rezultate konkrete për biznesin tuaj!

AIDA dhe AIC, në bashkëpunim me bashkitë e vendit, sjellin fushatën kombëtare me një qëllim të përbashkët: t'i japin sipërmarrjeve lokale mjetet për të rritur biznesin e tyre si:

Financim | Eksport | Standarde Evropiane | Partneritete | Hapësira të Reja

Na ndiqni për të mesuar datën dhe vendndodhjen e takimit në qytetin tuaj!

🇹🇭 Shtator 2026 – Prill 2027

AIDA

AIDA ju ofron mundësi për zhvillimin e biznesit tuaj si:

- Mbështetje për biznesin
- Mundësi financimi dhe zhvillimi
- Akses në platforma dhe rrjete biznesi
- Mundësi për eksport dhe zgjerim
- Kontakte dhe partneritete të reja
- Pjesë e rrjetit AIDA

AIC

AIC ju ofron mundësi për zhvillim dhe investim si:

- Akses më i shpejtë
- Hapësira të reja për zhvillim
- Mjedis funksional dhe tërheqës
- Siguri dhe transparencë në proces
- Mundësi strategjike për zhvillim

Thirrje për shprehje interesi në panairin ProWine Shanghai 2026

AIDA fton kompanitë shqiptare të sektorit të verës të shprehin interesin për pjesëmarrje në Pavijonin Kombëtar Shqiptar në ProWine Shanghai 2026, panairi më i madh profesional i verës dhe pijeve alkoolike në Kinë dhe një nga platformat kryesore të industrisë në tregun aziatik.

 Shanghai, Kinë
 10–12 Nëntor 2026

Pjesëmarrja në këtë panair synon të rrisë promovimin e verës shqiptare, krijimin e kontakteve të reja tregtare dhe zgjerimin e eksporteve drejt tregjeve aziatike. ProWine Shanghai mbledh importues, distributorë, rrjete tregtare, profesionistë të HoReCa-s, somelierë dhe ekspertë të industrisë nga e gjithë bota.

AIDA do të mbështesë pjesëmarrjen në Pavijonin Kombëtar Shqiptar, hapësirën ekspozuese dhe organizimin e takimeve B2B dhe aktiviteteve të përbashkëta promovuese.

Kompanitë pjesëmarrëse do të mbulojnë:

- Shpenzimet e transportit dhe akomodimit të përfaqësuesve të tyre;
- Transportin ndërkombëtar të mostrave dhe produkteve që do të ekspozohen;
- Çdo shpenzim tjetër individual që nuk lidhet drejtpërdrejt me organizimin e Pavijonit Kombëtar.

Ftohen të aplikojnë kompanitë që:

- Kanë eksperiencë eksporti dhe prezencë në tregjet ndërkombëtare;
- Disponojnë kapacitete të përshtatshme prodhuese dhe eksportuese;
- Ofrojnë produkte me standarde të larta cilësie dhe potencial për tregjet ndërkombëtare.

Kompanitë e interesuara mund shprehin interesin duke dërguar email në: info@aida.gov.al

 Afati deri më 6 shtator 2026.

Vendet janë të limituara dhe përzgjedhja e kompanive do të bëhet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara nga AIDA, me synim një përfaqësim sa më dinjitoz të verës shqiptare në këtë treg me potencial të lartë.

Një tjetër mundësi për ta çuar verën shqiptar

Thirrje për Shprehje Interesi | Forumi Ekonomik Shqipëri – Qipro

Mbi mundësinë e organizimit të Forumit Ekonomik Shqipëri – Qipro

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) po vlerëson mundësinë e organizimit të Forumit Ekonomik Shqipëri – Qipro. Për këtë qëllim, AIDA fton kompanitë shqiptare të shprehin interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë nismë dhe për të eksploruar mundësitë e bashkëpunimit me tregun qipriot. Ky proces do të shërbejë për të vlerësuar interesin e komunitetit të biznesit dhe për të mbështetur organizimin e forumit.

Kjo thirrje u drejtohet kompanive që synojnë:

- Zgjerimin e aktivitetit në tregun e Qipros;
- Krijimin e partneriteteve të reja të biznesit;
- Zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe investimeve;
- Promovimin e produkteve dhe shërbimeve shqiptare në tregun qipriot.

Ftohen të shprehin interesin e tyre kompani nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë, duke dërguar një email në adresën info@aida.gov.al.

Afati për shprehjen e interesit: 6 shtator 2026.

! Shprehja e interesit nuk përbën angazhim për pjesëmarrje. Organizimi i Forumit Ekonomik Shqipëri – Qipro do të vlerësohet në bazë të nivelit të interesit të shprehur nga kompanitë shqiptare.

 **THIRRJE PËR SHPREHJE INTERESI**

 **FORUMI EKONOMIK SHQIPËRI – QIPRO** 

Fokus i Forumit:

- Aktiviteti ekonomik dypalësh;
- Partnerët e rinj;
- Marrëdhëniet tregëtare;
- Prezantin: produkteve dhe shërbimesh.

Aplikoni deri më 6 shtator 2026

THIRRJE SHPREHJE INTERESI

AIDA fton kompanitë shqiptare të verës në Pavijonin Kombëtar në ProWine Shanghai 2026 – panairi më i madh i verës dhe pijeve alkoolike në Kinë

 ProWine SHANGHAI

 10–12 Nëntor 2026
Shanghai, Kinë

SHPREHNI INTERESIN
info@aida.gov.al

Thirrje për shprehje interesi | Forumi i Biznesit Kroaci-Shqipëri | Zagreb, Tetor 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Dhomën Kroate të Ekonomisë (HGK), po organizon Forumin e Biznesit Kroaci-Shqipëri, i cili do të zhvillohet në Zagreb, Kroaci, gjatë muajit Tetor 2026.

Forumit ka për qëllim forcimin e marrëdhënieve ekonomike dhe tregtare mes dy vendeve, përmes prezantimeve institucionale, sesioneve të diskutimit dhe takimeve B2B mes kompanive shqiptare dhe kroate.

Kompanitë shqiptare të interesuara për pjesëmarrje mund të dërgojnë shprehjen e interesit në adresën: info@aida.gov.al

Ju mirëpresim të bëheni pjesë e këtij aktiviteti!



Ftesë për pjesëmarrje në Balkan Business Dialogue

Më 23 shtator 2026, në Green Village, Nieuwegein, Holandë, zhvillohet Balkan Business Dialogue, një aktivitet i organizuar nga Ministria Holandeze e Punëve të Jashtme në bashkëpunim me Agjencinë Holandeze të Ndërmarrjeve (RVO).

Takimi do të sjellë së bashku kompani, investitorë, institucione dhe politikëbërës për të diskutuar mbi mundësitë e biznesit, investimeve dhe bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor.

AIDA fton kompanitë, shoqatat dhe aktorët e interesuar shqiptarë të marrin pjesë në këtë aktivitet dhe të krijojnë kontakte të reja me partnerë holandezë dhe rajonalë.

23 shtator 2026
Green Village, Nieuwegein, Holandë
13:30–17:30

Regjistrimi: <https://www.rvo.nl/evenementen/balkan-business-dialogue>

MOS 2026, Forumi “Slovenia–Albania: An Economic Bridge” | 17 Shtator

MOS Fair 2026 po afron! 🇸🇮
Celje, Slloveni | 16–20 Shtator 2026

Në kuadër të MOS Fair 2026, më 17 shtator, së bashku me SPIRIT Slovenia dhe ISR, do të zhvillohet forumi “Slovenia–Albania: An Economic Bridge”, një platformë dedikuar bashkëpunimit ekonomik, me fokus sektorin e përpunimit të drurit.

🕒 14:00–16:00
📍 MOS Fair, Celje
📅 17 Shtator

Një mundësi për të sjellë më pranë kompanitë, institucionet dhe partnerët e të dy vendeve dhe për të eksploruar mundësi të reja biznesi, investimi dhe bashkëpunimi.

🔗 Siguroni pjesëmarrjen tuaj në linkun:
<https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLScIsw68QaUNUb9qacLmpnZg7kJARg8lihtTotGuTpvGS-XbzA/viewform>

Pjesëmarrja u ofron bizneseve shqiptare një platformë konkrete për ndërkombëtarizimin e markës së tyre, promovimin e kapaciteteve përballë blerësve e distributorëve evropianë, si dhe njohjen me trendet më të fundit të tregut ndërkombëtar.



Balkan Business Day

23 Shtator 2026 | Ora 13:30 – 17:30
Green Village, Nieuwegein, Holandë

- Biznes & Investime
- Networking & Bashkëpunim
- Promovim i Mundësive Ekonomike

Regjistrohu deri më 31 Gusht 2026